



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH**

**RELACION TEKNIK**

**Objekti: Sistemim – Asfaltim i lagjes Xhile Liçi ( mbrapa konviktit ), bashkia Gramsh”**

**Të përgjithshme**

Ky objekt përfshin asfaltimin e rrugëve të brendshme të zonës mbrapa konviktit, në lagjen Xhile Liçi. Së bashku me asfaltimin e rrugëve të brendshme, do të realizohet edhe punimet e trotuareve, dhe sistemimi i ujrave të bardha në kanalizimet përkatëse të cilat do të sistemohen nëpërmjet kuletave prej betoni dhe pjerrësisë së rrugës që ujrat të shkojnë në pustetat e përcaktuara në projekt, punime për vendparkimin e makinave, si dhe punimet e ndriçimit të zonës. Totali i rrugës së asfaltuar të parashikuar në projekt është 810 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja e trotuareve është parashikuar 60 m<sup>2</sup>.

**Gjendja aktuale**

Aktualisht, kjo zonë ndodhet në kushte të vështira për sa i përket infrastrukturës së rrugës, në mungesë të plotë të trotuarëve, si dhe ujrat sipërfaqësore janë të pa sistemuara. Për këto arsye, këta banorë kanë kërkuar sistemimin dhe asfaltimin e kësaj lagjeje.

**Vizioni**

Bashkia Gramsh ka hartuar projektin dhe kërkon ta implementojë atë duke synuar shndërrimin e kësaj zone të paurbanizuar në një mjedis të përshtatshëm urban, të pajisur me gjithë infrastrukturën e duhur sa më afër nevojave të komunitetit, duke shmangur fenomenet e padëshirueshme si psh përmbytjet.

**Përshkrimi i punimeve**

Në këtë projekt janë përfshirë punimet e ndërtimit të rrugëve, trotuarëve, kanalizime të ujrave të bardha, parkime dhe lulishte.

1. Punime prishje parashikon prishje shtresave të betonit breza shkalle, si dhe shkulje bordurash betoni ekzistuese dhe transportimin e tyre në vendin e përcaktuar për mbetjet inerte.

2. Punime në rrugë që përfshin gjurmimin e trasesë së rrugës, punime të shtresave të domosdoshme si zhavorr, cakull, stabilizant, bitum.
3. Punime për kanalizimet e ujrave të bardha në të cilat përfshihen betonimet për kunetat.
4. Punime për vendparkimimin e automjeteve në të cilën përfshihen punimet e gjurmimeve në seksion dhe të lirë dhe për themele, F.V të borduravë të betonit, betonim të themeleve të tyre, punime shtresash e struktura të betonit.
5. Punime trotuari të cilat konsistojnë në gjurmimin e dheut të lirë dhe për themele, F.V bordurave të betonit, si dhe trotuari me pllaka betoni.
6. Punime të gjelbërimit të cilat konsistojnë në mbushje me dhé të pasuruar, sistemime, mbjellje me bar dekorativ, peme dhe shkurre dekoruese, stola dhe minikosha.
7. Punime ndriçimi të cilat konsistojnë në shtrirjen e kabullit të ndriçimit dhe vendosjen e shtyllave elektrike.